

i kufizuar, inicialet pas çdo fjale të urtë na duken të tepërta. Ato e kanë vendin në fund të vëllimit, në aparatoren shkencore.

Një pjesë e madhe e fjalëve të urta janë përsëritur. Autori shpesh ka dhënë fjalë të urta, fare të ngjashme, nga treva të ndryshme ku banojnë shqiptarët. Thuaje libri ka pretendime regjionale të fjalëve të urta shqipe dhe të trajtave dialektologjike. Një numër i konsiderueshëm fjalësh të urta janë shënuar gabimisht e shumë sosh nuk janë të tilla. Në vijim disa nga këto mendime po i konkretizojmë.

Duke u mbështetur kryesisht në anën formale të fjalës së urtë shqipe në vëllim janë përsëritur shumë sosh. Kështu, fjala vjen, Sa e ke jorganin, zgati komt (1443-P), Sa e ke plafin, shtrij kâmt (1444-Gj), Shtrij kam't sa e ke jorganin (1574-F), Sa e ke jorganin, zgjati kamët (279 — në shtojcë), Shtrij kâmët sa të m'rriin plafta (307 — shtojcë). Këtu më poshtë, me numra, po shënojmë edhe disa sosh që janë identike ose fare të ngjashme: 48,54; 127,1524,19 (sht.), 294 (sht.); 180,282; 29,119; 180,282; 293,352; 311,1014; 320,321; 342,349; 352, 354; 360,361; 477,478; 534, 1549,110 (sht.); 533,553; 591,1345,1483; 609,648; 656,658; 661,1020; 666,668,1026,3 (sht.), 142 (sht.) 211 (sht.); 775,1417; 776,777; 903,1056, 1291; 297,994; 962,978; 977, 1274; 971, 1061; 976,1075; 1115,1630; 1136,1144, 1153, 1317,746,225 (sht.), 256 (sht.); 976,1169; 1198, 1199; 1176, 1272, 1276; 1309, 1677, 1379; 1417, 1456; 1437, 1514; 1100, 1476, 1491, 1495; 1545, 1546, 1548. Janë shënuar gabimisht këto fjalë të urta: 7, 8, 26, 60, 79, 81, 126, 162, 189, 293, 306, 311, 348, 385, 435, 437, 456, 553, 566, 596, 608, 613, 670, 678, 691, 713, 716, 729, 735, 753, 755, 760, 765, 798, 803, 814, 825, 859, 860,

872, 893, 901, 984, 1036, 1140, 1206, 1223, 1251, 1282, 1284, 1331, 1354, 1372, 1399, 1513, 1534, 1588, 1627, 1636, 1698, 1701. Janë frazeologjizma, kashelasha apo shprehje të tjera e jo fjalë të urta: 3, 27, 37, 38,65, 68, 70, 72, 149, 154, 185, 209, 215, 222, 230, 237, 238, 239, 242, 252, 266, 268, 270, 271, 296, 323, 335, 338, 381, 390, 394, 396, 399, 412, 414, 426, 434, 436, 439, 440, 460, 461, 467, 473, 490, 491, 496, 504, 563, 565, 573, 577, 580, 620, 627, 762, 779, 919, 937, 973, 997, 1003, 1022, 1076, 1088, 1152, 1171, 1245, 1393, 1480, 1601, 1603, 1604, 1606, 1652; 1669. Sa i përket moskonsequencës në të shënuarit e shprehjeve dhe fjalëve po marrim vetëm një shembull. Fjalën këmbët e ndeshim në këto forma: *kamt*, *kâmt*, *kam't*, *kamër*. Shpesh ndeshim *nji* në vend të *ni*, si theksohet në popull etj. Autori nuk është konsequent as sa i përket përdorimit të shenjave të interpunksionit.

Shtojca — *Fjalë të urta shqipe — sërbokroate*, që sipas mendimit tonë nuk e ka vendin në një vëllim të një natyre të këtillë, është një kontribut i çmueshëm, ku janë krahasuar mbi 300 fjalë të urta shqipe me proverbat e ngjashëm sërbokroatë. Ndonjë fjalë e urtë, për të cilën autori thotë në parathënie se e ka marrë nga materiali i botuar në vëllim, nuk gjendet në përmbledhje, si fjala vjen, fjalët e urta nr. 161, 316 (të dyja në shtojcë) etj.

Në fund, pos fjalorit, ku janë shpjeguar edhe disa fjalë të zakonshme si demel, dimit, gûha, gjogu etj., gjendet dhe rezymea në gjuhën shqipe, për çka natyrisht duhet t'u zihet për të madhe edhe autorit, edhe botuesit. Ajo eventualisht duhej të ishte e shkruar në një rën nga gjuhët botërore, sepse si e tillë është e tepërt.

ANTON BERISHA

V. S. Karadžić: „ENTOGRAFSKI SPISI” (Shkrime Etnografike) Nolit, Beograd, 1972, f. 682.

Në mesin e shumë shkrimeve të Vuk Stefanoviç Karaxhiqit, vend të posaçëm zënë ato nga fusha e etnografisë. Ato prekin shumë momente të jetës së gjerë të popullit: krijimtarinë doket, zakonet, bestytnitë etj. por kanë ngelë të pasistemuara dhe të paklasifikuara në një rën nga degët e këtij lëmi shkencor.

Megjithatë, duke u nisur nga fakti se Vuk Stefanoviç Karaxhiq qiti në letër i pari studimet mbi popullin e vet, e quajnë themelues të shkencës së etnologjisë sërbe.

Libri „Etnografski Spisi” (Shkrime Etnografike) është një përmbledhje e veprave të zgjedhura Vuk S. Karaxhiqit, që doli me rastin e njëqindvjetorit të vdekjes së tij, pregatitur nga Milenko S. Filipoviç. Është kjo një përmbledhje punimesh, të cilat për kah struktura tematike e problemit të shtruar janë mjaft heterogjene, por me një vlerë të posaçme etnografike.

Artikulli i parë është *O Milošu Obiliću* (Mbi Milosh Obiliçin). Duke u bazuar në të dhëna mitologjike dhe gojëdhëna popu-

llore, autori, në këtë punim Milosh Obiliqin e nxjerr si trim të njohur me prejardhje sllave nga rrethina e Cerit-Sërbia VP.

Në artikullin e dytë të kësaj përmbledhje *Kmet*, Vuku, duke u nisur nga studimet e tij personale në teren si dhe nga ato të marra nga J. Gavrilloviqi dhe shumë të dhena të tjera nga populli, tenton të paraqesë sa më qartë çifçillëkun si institucion të popullsisë së atëhershme. Rëndësia më e madhe e këtij punimi qëndron në faktin se ai i krahasoi çifçinjtë, mjeshtërinë, detyrat dhe veprimtarinë e tyre, në Sërbi, Bosne, Hercegovinë dhe Mal të Zi. Nga kjo fitojmë mundësinë të njohim rrethanat ekonomiko-shoqërore në një formacion kalimtar shoqëror.

Vend të posaçëm në fushën e etnografisë zë vepra *Kovčević za istoriju, jezik i običaje Srba sva tri zakona* (Arkëz për historinë, gjuhën dhe doket e sërbeve të të tri besimeve). Është kjo vepër kryesisht me tematikë etnologjike! Përfshin gjithsej 87 faqe dhe ndahet në katër kapituj! Secili kapitull paraqet një artikull të veçantë, ku trajtohen probleme të ndryshme nga lëmi i etnografisë.

Në artikullin e parë të kësaj vepre (f. 31—48) *Srbi svi i svuda* (Sërbë të gjithë dhe kudo) trajtohet një problematikë më tepër linguistike, por nuk i mungon as vlera etnografike. Në të bëhet fjalë për shtrirjen e popullsisë sërbe, për ndarjen e tyre gjuhësore dhe fetare. Krahas të dhënave për popullsinë me prejardhje sllave, autori përmend edhe popullsinë shqiptare, duke dhënë ca karakteristika të tyre etnike, andaj ky moment zgjon interesim për njohjen e virtyteve etnografike të popullsisë ballkanike, në një sferë më gjerë nacionale.

Duke folur për përzjerjet fetare dhe gjuhësore të popullsisë sllave, si dhe për shtrirjen territoriale të saj, autori përmend edhe një numër të popullsisë së romanizuar, e cila jetonte në Bačkë, Srem, Slavoni dhe Kroaci, që ai e konsideron si popullsi sllave, por të romanizuar. Mirëpo, kur është fjala për prezentimin e tyre në mesin e popullsisë tjetër (ortodokse), se si ata e ndiejnë dhe e quajnë veten, autori i largohet disi konstatimit të sigurtë në mënyrë të tërheqjes, gjoja se këta banorë (sllavë) janë të çuditshëm, dhe prezentohen „... Bog zna čijim imenima, iliri ili Ilirci; ... u Bačkoj zovu ih Bunjevcima, ... može bit da se zovu od reke Bune, od koje su se, kao što se pripovjeda, negda amo doseljili, ... ili u Srijemu, u Slavoniji i u Hrvatskoj zovu ih Šokcima, može bit od Talijanske rječi s c i o c c o ?, podsmjeha radi, ... ali danas i oni sami reku n.p. „ja sam Šokac”

„ja sam Šokica” kao i „Bunjevac i Bunjevka”, f. 32. Mendojmë se mund të ekzistojë supozimi së është fjala për popullatë me prejardhje shqiptare, e cila ruajti vetëthirrjen ilirë (Iliri) ose ilirjanë (Ilirci), pastaj bunac (Bunjevci), për të cilët edhe autori supozon se e kanë prejardhjen nga rrethina e luginës së lumit Buna-zonën gjeografike të të cilit ai e quan Hercegovinë. Apo edhe fjala shoko s c i o c c o në italishtet, që ka në këtë rast kuptim përqeshës, me domethënie: i trashë prej mendësh, budalla, i pagdhundur etj., e cila prej popullsisë së Sllavonisë, Sremit dhe asaj të Kroacisë, i është mveshur kësaj popullsie të romanizuar. I njëjti rast ka ndodhur edhe më vonë, ku popullsisë shqiptare i janë ngjitur fjalët të tilla përqeshëse (në periudhën para Luftës së Dytë Botërore). Duhet shtuar se nëse kjo popullatë vërtetë ka prejardhje shqiptare, ata veten shok-shokica, në ambientin e caktuar, e quajnë jo me kuptim përqeshës, por duke u nisur nga fjala shqipe shokë — me kuptim, të shoqëruar, miq, janarë, dashamirë etj. vetëm për t’iu aklimatizuar ambientit përkatës.

Autori, duke parë ndasinë fetare, si dhe, marrëdhëniet jo të mira mes popullsisë sllave në atë kohë, merr si shembull popullsinë shqiptare (Arnauti, sipas autorit) të feve të ndryshme: krishterë, ortodoksë dhe muhamedanë (turke-Turçini, sipas autorit) dhe, paraqet lidhmërinë e tyre kombëtare, pa marrë parasysh ndasinë fetare të tyre, vetëm për t’i treguar, për ta mësuar dhe bindur popullin e vet se feja është irelevante për një popull, në krahasim me kombësinë: „... njih (Arnauta) ima i Rimskoga i Grčkoga i Turskoga zakona, pa se svi zovu Arnauti, i da rećemo da se izmedju sebe malo mrze, ali prema drugim narodima žive kao braća ... i jedan bi od njih Turskoga zakona ubio deset pravih Turaka za jednoga Arnautina makar koga hrišćanskoga zakona, kao što bi i arnautin Rimskoga zakona ubio deset Talijanaca za jednoga Arnautina Turskoga zakona” f. 32.

Artikulli i dytë e *Boka Kotrska* (Boka e Kotorit), (f. 48—58.) është më tepër një punim etnografik-antropogjeografik. Përveç karakteristikave gjeografike të atij visi, apo regjioni, në të bëhet fjalë edhe për doko e zakone të popullsisë së asaj anebokelëve. Poashtu autori flet dhe për jetën ekonomike të popullsisë, duke krahasuar çmimin e gjërave të tregje. f. 56.

Risanski običaji (Zakone popullore të Risanit) është artikulli i tretë i këtij libri, (f. 58—110), në të cilin bëhet fjalë për mar-

tesën (1. Ženidba), duke përshkruar hollësisht doke e zakone rreth fejesës, si për palën mashkullore, ashtu edhe për atë femërore. Këtë e ka pasuruar edhe me këngë të ndryshme, të cilat i këndonte populli i atij vendi në rast martesë, pastaj kur femrat shkojnë te kroi për të mbushur ujë, me këngë të krushqisë, të dhëndrrit, këngë të pasdarkës, të cilat i këndojnë krushqit-dasmorë, duke hedhur valle, këngë të kënduara nga femrat, për nusen që e marrin, pastaj, këngë në shtëpinë e dhëndrrit ku e kanë sjellë nusen, këngë të drejtuara zotit të dasmës, për nusen e mirë etj.

Në kaptinën e dytë *Naricanje za mrtvima* (Vajttime për të vdekurit) f. 96—110, autori i përshkruan vajtimet dhe jep disa shembuj vajtimesh, që bën nëna për djalë, fëmijët për nënë, pastaj vajtimet kur të vdekurin e nxjerrin prej shtëpisë dhe e nisin për në varr. Gjithashtu jep shembuj të vajtimit që i bën nëna për të birin (sidomos kur ai ka qenë i martuar dhe pas vetes ka lënë bonjakë) pasi që të bëhet varrimi dhe të kthehen në shtëpi, më të cilin rast e ëma përkulet para këmbëve të priftit dhe vajton për të birin, kushtet e vështira për mbajtjen e bonjakëve dhe dhëmbjen e saj për vdekjen e të birit. Dhe, më në fund jep vajtimet, të cilat bëhen ditën e tretë të varri i të ndjerit.

Srpske Zdravice f. 110—118 — (Dolli sërbe), materialet e këtij punimi autori i mori nga bashkëpunëtori i tij nga Risani, prifti Vuk Popoviq, të cilat materiale i kishte përshkruar ai nga prifti i ndjerë, Marko Komnenoviq, nga Krivoshja. Në mënyrë të denjë janë paraqitur dollitë sërbe gjatë festave, për nderë të mikpritësit — të zotit të shtëpisë, për shëndetin e tij, pastaj dolli për nderë të miqësisë, për nderë të tubimeve dhe kuvendeve etj.

Në fund të këtij punimi, autori ka paraqitur edhe listën e pajtimtarëve të këtij libri: *Imena GG-Prenumeranata*, 118—140. f. Nga numri i shumtë i pajtimtarëve, nga struktura e tyre profesionale, ekonomike dhe veprimtaria shoqërore, si dhe nga shpërndarja e tyre territoriale — gjeografike në vende të ndryshme të Jugosllavisë dhe të shteteve të tjera evropiane, mësojmë mjaft për rëndësinë dhe reklamimin e këtij libri në sferën e gjerë të lexuesve.

Život i običaji naroda Srpskoga f. 145—404. (Jeta dhe zakonet e popullit sërbi), është vepër e gjetur në dorëshkrim, e papërfunduar, me disa vërejtje të autorit.

Në vitin 1867, katër vite pas vdekjes së autorit, është botuar në Vjenë pa kurrfarë ndryshimi apo plotësimi.

Libri ndahet në tetë kaptina. Në fund ka të botuar si shtojcë listën e pajtimtarëve. Materialet, të cilat janë shtruar në këtë libër, janë me tematikë të ngushtë etnologjike. Në kaptinën I (f. 153—216) bëhet fjalë për zakone rreth festave të ndryshme; për zakone rreth ngjarjeve më të rëndësishme njerëzore (f. 217—300 — kaptina II); për besime në sende, të cilat nuk ekzistojnë (f. 301—308—kaptina III); për ekzistimin e atyketushëm të disa sendeve (objekteve), të cilat tregohen nga populli (f. 309—320—kaptina IV); për trima dhe atllarët e tyre (f. 320—324—kaptina V); për jetën (f. 325—342—kaptina VI); për lojra (f. 343—355—kaptina VII); për zakone ose fe (f. 356—360—kaptina VIII). Si shtesë janë dhënë dy punime që paraqesin zakone rreth dasmave dhe kthimit të vajzave në Srem (f. 361—378). Në fund ndodhet lista e pajtimtarëve (f. 379—406). Me fjalë të tjera në këtë libër, autori ka paraqitur në mënyrë të hollësishme doket e zakonet e popullit, të cilat i ka hasë në jetën e përditshme dhe i ka parashtruar ashtu të ruajtura me shembuj konkretë. Prandaj, vepra në fjalë paraqet jetën në rrethana të caktuara dhe aktuale, për kohën kur është shkruar.

Në faqën 407, 408, *Različita gradja* (Materiale të ndryshme) jepen disa të dhëna lidhur me prejardhjen e fjalëve, terma etnologjikë, shënime statistikore për persona dhe familjet e tyre etj. Këto nuk kanë ndonjë vlerë të posaçme, nga se janë deskriptive dhe të pakëta.

Punimi, *Gradja za etnografske karte* (Materiale për harta etnografike) f. 409—411., përveç që përmban të dhëna për vendbanime dhe përcaktimin e shtrirjes së tyre gjeografike, ka edhe shënime statistikore-demografike, të cilat i përkasin strukturës familjare dhe nacionale. Në këtë rast autori i ndan shënimet sipas përkatësisë fetare, duke shtuar të dhëna për gjendjen ekonomike, por, vetëm me përcaktime relative; gjendjen e mirë ose të vështirë. Këto të dhëna dhe materiale, të cilat preferohen për harta etnografike, paraqesin vetëm një ndihmesë të vogël në atë aspekt, por më tepër mund të merren si shtojcë e një fakti kur është fjala për një përcaktim aproksimativ, qoftë të numrit të familjeve, numrit të shtëpive, përkatësisë së tyre etnike-fetare, apo edhe të gjendjes ekonomike.

Në kaptinën e veçantë (libri i 17) me titull: *Dodaci* (Shtesa), f. 415—510.

janë dhënë disa vërejtje të autorit për punimet dhe veprat, të cilat i zumë në gojë më parë, për gabimet teknike në to gjatë procesit të punës në shtyp, apo ndonjë lëshim që është bërë nga ana e autorit, për konstatime apo diç tjetër. Këto vërejtje kanë vlerë të posaçme, jo vetëm pse i evitojnë gabimet teknike, por edhe për përmirësimet, të cilat i ka bërë autori për lëshimet e mëparme. Ka plotësime e shtesa të reja, me fakte të reja, që gjithsesi janë me interes të posaçëm dhe shtojnë vlerën e librit.

Pasthënia, f. 513—580, shkruar nga Milenko S. Filipoviçiqi, i cili e përgatiti këtë përmbledhje, është tejet e rëndësishme dhe me një vlerë të posaçme. Në të, në pika të shkurta, paraqitet jeta dhe krijimtaria e Vuk S. Karaxhiqit në fushën e etnografisë, të cilin e quan edhe themelues të kësaj dishipline shkencore në Sërbi.

Kaptina e veçantë *Shënime mbi këtë botim*, f. 581—674., shton vlerën e këtij libri, sidomos paraqitja e regjistrave të emrave të shkoqitur: të familjeve, emrave

personalë, emrave gjeografikë dhe kuptimit të tyre, kuptimeve etnologjike, pastaj regjistri i sendeve (objekteve), i pajtimtarëve dhe regjistrimi i mbledhësve të pajtimtarëve nëpër vende.

Janë dhënë ca ilustrime për veprat e botuara, qoftë si të veçanta apo nëpër revista e gazeta të ndryshme të kohës, duke ruajtur shënime, të shumtën origjinale, për fizionominë e revistës së atëhershme.

Libri *Etnografski Spisi*, i cili paraqet përmbledhje punimesh të V. S. Karaxhiqit, të përgatitura për shtyp nga Milenko S. Filipoviçiqi, mendojmë se është një kontribut për lëmin e etnografisë. Ky libër do të jetë një ndihmesë jo vetëm për njohjen e dokeve e të zakoneve të popullit sërb, apo në përgjithësi sllavë, por do të shërbejë, në rast eventual, për studjuesit tanë të këtij lëmi, që të bëjnë krahasime në punën e tyre kërkimore-shkencore mes popullsive me përkatësi të ndryshme etnike.

UKË XHEMAJ

SOCIOLOGIJA SELA, 40—42.: „BRAK, PORODICA I SRODSTVO U SELU”, (Martesa, familja dhe farefisnia në fshat) grup autorësh, Zagreb, 1973, f. 278.

Revista shkencore „Sociologija Sela” nr. 40—42, trajton një tematikë me rëndësi nga ambienti fshatarak. Në 278 faqe të kësaj reviste janë botuar 23 punime shkencore, mjaft ineresante, të lidhura ngushtë me problematikën e familjes, mënyrat e organizimit në kuadër të saj në farefisni dhe në ambientin e fshatit.

Mr. Ružica First-Dilić *Hipotetski okvir za istraživanje poljoprivredne porodice* (Suaza hipotetike për studimin e familjes bujqësore) f. 5—20. Duke bërë analizën e problematikës së familjes dhe të organizimit të jetës së saj, autorja vë në dukje vendin dhe rëndësinë e familjes në literaturën sociologjike, etnografike dhe antropologjike. Trajtimin e familjes fshatare-bujqësore ajo e studjon në këtë punim, duke ditur rëndësinë e saj si grup shoqëror në organizimin e jetës ekonomike — shoqërore, në kushtet specifike të fshatit tonë.

Duke bërë analizën e familjes në retrospektivë, autorja nxjerr rëndësinë dhe funksionin e saj edhe në botën bashkëkohore, dmth. përcakton relevantitetin edhe në perspektivën e ardhshme. Kështu, mendon edhe Smith, kur shton „... agjencia në të cilën prodholet shumica e popull-

sisë së ardhshme, si e fshatit ashtu edhe e qytetit, është familja bujqësore...”¹

Në analizat e saj të para, autorja ka bërë klasifikimin e formave të familjeve në tipe ideale, duke iu shmangur lidhmërisë së tyre me bujqësinë individuale si kusht të ekzistimit, por proporcionalisht duke marrë në konsiderim disa kriterë të tjera të klasifikimit, në mënyrë që më vonë familjes bujqësore, si një specifikum, me metodën analitike, t’i tregojë se ajo me elementet e veta, cilit tip të familjes ideale i afrohet më tepër. Këto dy mënyra të qëndrimit plotësohen në mes veti në mënyrë kauzale. Tipologjizimi lehtëson zhvillimin e orientimit teorik-analitik, gjersa trajtimi analitik mundëson revidimin e tipologjisë së konstatuar, e veçanërisht të kriterëve të shfrytëzuara.

Për klasifikimin e tipeve të familjeve, autorja ka marrë për bazë një seri faktesh dhe shënimesh mbi familjen, në mënyrë që, duke i studjuar hollësisht, ta bëjë klasifikimin e familjeve rurale në tri tipe kryesore, për të cilat edhe bën fjalë në këtë punim: *familja e zgjeruar, familja trung dhe familja e ngushtë*. Për të tri tipet e familjeve ajo jep karakteristikat, duke bërë përkufizime në

¹ Smith, L. T. — Zopf, P. E., Jr.: *Principles of Inductive Rural Sociology*, Philadelphia, F. A. Davis Company, 1970, p. 291.